

# **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

## **ORIGJINË SHTAZORE**

### **I** **1.VEZË**

*Bazuarnë STASH 1411/87*

*Bazuar në STASH 325-1:1993 ose ekuivalentin e tij  
Bazuar në Ligjin nr. 9308 datë 04.11.2004, “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”,  
për normat e tregëtimit të zbatueshëm për vezët, Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2002 të  
Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Udhëzimit nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrit të  
Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrit të  
Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë  
20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet  
ushqimore”*

#### **Veze pule e kategorisë A.**

##### **Treguesit Organo-Leptikë:**

**Pamja e jashtme:** Masa ne gramë: Jo më pak se 50 gr.

##### **Kërkesat cilësore**

Pamja e jashtme, e pastër dhe pa krisje. Lejohen ndotje të lehta.

Dhoma e ajrit (lartesia) mm, jo me shume se 9 mm.

E bardha e vezës: E dendur e kulluar dhe e pastër panjolla gjaku(të kontrolluar në ovoskop)

E verdha e vezës: Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror

**Era:** Pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj

Çdo kokërr duhet të jetë e vulosur ku të përmbajë markën dhe datën e skadencës.

Veze të kategorisë A duhet të paisen me një ose më shumë shenja dalluese:

- Kategoria e cilësisë
- Kategoria e peshës
- Numri i qendrës së ambalazhimit.
- Emri i qendrës së ambalazhimit.
- Shenja e qendrës së ambalazhimit
- Treguesi për origjinën e vezës.
- Kodi i identifikimit të kompanisë.

Veze të ambalazhohen ne kartona fole me kapacitet 30 veze secila dhe ne çdo kuti ambalazhi, kartoni vendosen 12 cope kartona fole.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohen:

Emri i ndërmarrjes prodhuese,

Sasia e vezëve,

Data e skadencës.

## **Kushtet e ruajtjes dhe të transportit**

Veza magazinohet dhe transportohet në temperaturë konstante, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen optimale të vetive higjenike të tyre.

Vezët magazinohen në ambient me temperaturë  $-0.5^{\circ}\text{C}$  der në  $+2^{\circ}\text{C}$

Vezët shpërndahen te konsumatori brenda një afati kohor maksimumi 21 ditë nga prodhimi i tyre.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza mikrobiologjike”.

- Salmonella

“Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

## **II.**

### **QUMËSHTI DHE NËNPRODUKTET E TIJ**

#### **1. QUMËSHT UHT TETRPAK**

*Bazuar ne STASH 1563/87, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, Udhezimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.*

*Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,*

*Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”*

#### **Qumësht Uht Tetrapak**

##### **Kërkesat cilësore :**

Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Gjate përpunimit dhe tregëtimin të zbatohen rregullat higjeno sanitare e veterinare në fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Të plotësoje treguesit organo-leptikë dhe ato fiziko-kimikë.

##### **Pamja e jashtme:**

Të jetë leng homogjen, pa lende të huaja qe notojne apo precipitojnë me rrjedhje të njëllotë dhe pa ndërprerje.

**Ngjyra** e bardhe e njëllotje, nuance e lehte e verdhë .

**Shija dhe era** te kendeshme, lehtesisht e ëmbël, pa shije ose ere te huaj.

Qumeshti duhet të jete i ambalazhuar ne kuti tetrapak sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse, ne peshe 1 lit.

##### **Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):**

1. Dendësia në 20 gradë celcius 1.028 – 1.034 gr/litër.
2. Pika e ngrirjes jo më e lartë se  $-0,520$  gradë C
3. Proteina jo më pak se 28 gr/lit, e llogaritur duke shumzuar me 6.38 përmbajjen e azotit total të qumshtit të shprehur në %.
4. Përmbajtja e yndyrës në %, 3-3.4 %.
5. Aciditeti ne grade Tjorner:  
Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars jo me i lartë se se 19

Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator jo me i lartë se se 20

6. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %

7. Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidgezes) duhet negative.

Pastertia pa mbetje me site mendafshi apo merle pambuku dyfishe.

**Ambalazhimi** brenda kushteve higjeno-sanitare, me peshe 1 lit ku te jene vendosur:

**Etiketimi:** Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e skadimit.

Përqindja e yndyrës.

Temperatura e ruajtjes së produktit.

### **Analiza mikrobiologjike**

1. Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

2. A. total

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rruajtja e transportimi ne temperature 2 deri ne 8 grade.

Paketimi gjatë transportit duhet të jetë në kuti kartoni (koli) me nga 6-12 kuti qumshti secila.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Raport analizat e kërkuara:**

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

## **2.GJALP**

*Bazuar ne STASH 4010/82*

### **Treguesit Organo-Leptikë:**

**Lloji:** Gjalp i freskët dhe me kripë cilësia e parë

**Pamja :**E njëtrajtshme pa shtresa në prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbetje dhalli .

**Ngjyra :** Gjalpi i freskët ngjyra e bardhë deri në të verdhë,karakteristikë e kremes nga e cila prodhohet e njëllajtë në të gjithë masën. Konsistenca në temperaturën 10 – 12 °C, gjysëm e fortë.

**Era dhe shija :** e kendshme karakteristike e gjalpmit të freskët,pa erë dhe shije të huaj,lehtësisht e kripur .

### **Treguesit fiziko kimikë:**

1-Lagështira në % jo më shumë se17.

2-Lenda e thatë pa yndyrë në %,jo më shumë se 2.

3-Yndyra në %, jo më pak se 81 gjalpi i freskët dhe 79 gjalpi i kripur.

4-Kripë në % jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.

5-Aciditeti i shprehur në g/Ketshtofer jo më shumë se 3 gjalpi i freskët dhe 5 gjalpi i kripur.

6-Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

**Ambalazhimi:** Gjalpi i fresket dhe i kripur i ambalazhuar me peshë (sipas kërkesës) .

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ne të cilen shenohen:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit.

Data e skadencës.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpërdoret nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jënë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jënë pikë për pikë si të etiketës origjinale. Malli të shoqërohet me raportë analize të laboratorit.

**Ruajtja dhe transportimi:** Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 °C, Transportimi i gjalpës bëhet me mjete frigoriferike. Të jete i shoqëruar me raport analize të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

### **3. KOS**

*STASH 1443-87*

*Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”*

#### **Kërkesat cilësore**

Të plotesoje treguesit e cilësive si më poshtë:

- Ngjyra: e bardhe, në sipërfaqe e bardhe lehtësisht në krem.
- Struktura: e ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- Era dhe shija: e këndeshme, karakteristike e kosit të embël, lehtësisht e tharte.

#### **Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):**

- Aciditeti në grade Tjerner jo më shumë se 120
- Yndyra në %  $2 \pm 0.1$

#### **Analize mikrobiologjike**

- Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

#### **Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi**

Kosi ambalazhohet në paketim tetrapak, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me masë 500g - 1 kg të mbyllur dhe me kapak.

Ambalazhet që përdoren të jënë në gjendje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë të huaj.

Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjienosanitare nga standardet përkatëse.

Shmangiet e lejuara ndaj vëllimit nominal të kosit të ambalazhuar janë:

- $\pm 20$  g për ambalazhet 1000 g
- $\pm 15$  g për ambalazhet 500 g

Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërrmarjes prodhuese
- Emri i produktit .
- Përqindja e yndyrës
- Data e skadimit
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

#### **Ruajtja dhe transporti:**

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperatura nën 10 °C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Transporti bëhet me mjete të mbuluara, të pastra, me mjete frigoriferike.

Paketimi gjatë transportit duhet të bëhet në kuti kartoni ose paktim qeske vakumi me nga 6-12 shishe kosi secila.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

### **III.**

#### **MISH**

##### **1.MISH I FRESKËT VICI**

*Bazuar në STASH 1441/87*

*Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre.*

**Lloji:** Mish viçi i fresket, cilësia e pare.

**Treguesit Organo Leptikë :**

**Pamja e jashtme:**Muskulatura të jetë e plotë me ngrjër trendafil i çelët .Siperfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje ,në prerje duket e ndritshme jo e ngjitshme,me ngjyrë roze karakteristike, të ketë pak dhjamë të bardhë nën lekurë dhe diçka më tepër në brendësi,jo në gjendje të ngrirë .

**Duhet të jetë karkasë e plotë( Shpatull,kofsh dhe gjoks)**

**Çdo parti/karkasë mishi detyrimisht duhet të jetë i shoqeruar me çertifikatë veterinare, cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe me të cilën vërtetohet se nga kontrolli**

**Ngjyra:** Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe,dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur.Në prerje sipërfaqja është e ndritshme,ngjyra e dhjamt është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

**Era:** e këndshme , karakteristike e llojit.

**Palca e kockave :** Mbush plotësisht kanal in e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhe. Në preje është e ndritshme.

**Lëngu i mishit pas zierjes:** i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

**Konsistenca:** E butë dhe elastike ,gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Nuk duhet të ketë erë të huaj dhe nuancë jeshile në sipërfaqe. Tendinat janë të shndritshme elastike dhe të forta.

**-Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar pa të brendshme dhe kokë.**

**-Tregëtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë**

**-Mishi të jetë i cilësisë së parë,i shoqëruar me raport veterinar nga sherbimi veterinar i Komunave ose Bashkise ,viçi duhet të jetë 6-18 muajsh dhe me peshë deri 150 kg.**

**-Të mos ketë perqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.**

**-Transporti të bëhet me mjetet e firmës të specifikuara dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.**

**-Ruajtja në frigorifer në temperaturën nga 0 - 4 gradë.**

**-Afati i garancisë :12 orë nga koha e marrjes në dorëzim dhe përdorim .**

**-Mishi i freskët shoqërohet me dokument veterinar ditor (çertifikatën shëndetësore veterinare) dhe të jenë të lexueshme mirë.**

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

## **2.MISH PULE**

*Bazuar në STASH 1168/87*

*Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”*

Mishi i shpendëve fitohet nga therja dhe përpunimi i shpendëve të gjalla sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinare dhe sanitare në fuqi. Shpendët që kalojnë për therje duhet të plotësojnë kërkesat cilësore të standardit në fuqi, të shpendëve për therje dhe 15 ditë paratherjes iu ndërprit dhënia e antibiotikëve edhe e stimulantëve të tjerë.

Mishi i shpendëve duhet të jetë i pastër, pa mbetje të zorrës së trakesë, të kllোকës ose të pendëve. Në muskuj të mos ketë mbetje gjakut që shkaktohen nga ç'gjakësi mijoi rregullt.

### **Treguesit Organo-Leptike:**

**Pamja e jashtme:** Me ngjyrë rozë të çelur që anon në të bardhë karakteristike e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepërta dhjami, cilësi e parë.

Treguesit shqisore:

Për cilësinë e parë:

Mishi të ketë pamje të mirë me ngjyrë natyrale të llojit, ngjyrë e bardhë me nuancë të verdhë.

Muskulatura e gjoksit dhe e kofshëve të jetë e zhvilluar mirë.

Kocka e gjoksit (sternumi) të mos duket, tek gjelat e zogjtë mund të dallohet pak.

Në hapësirën e barkut të ketë shtresa dhjami, tek gjelat e zogjtë dhjami të jetë më i paktë.

Mishi i pulës nuk përfshin kokën dhe të brendshmet.

### **Ambalazhimi:**

Mishi i pulës duhet të jetë i ambalazhuar sipas standardeve në fuqi.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, duhet të jetë i sigurtë dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Materiali ambalazhues duhet të plotësojë “Standardet në fuqi për ambalazhimin e produkteve të mishit”, dhe të shoqëruara me Çertifikatë Cilësie.

Transportimi: Transporti i mishit të shpendëve behet me automjete frigoriferikë, me temperaturë të përshtatshme për ruajtjen e produkteve ushqimore të frekëta (jo të ngrira) 0- 4°C.

Transporti i mishit të freskët (jo i ngrirë), i paketuar, bëhet me arka plastike ose prej materiali që nuk ndryshket.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Marrja në dorëzim e mishit të shpendëve bëhet me parti, që jepet njëherësh për furnizimin me të njëjtin lloj dhe me të njëjten cilësi.

Pjesët që do të dorëzohen duhet të jenë në raport të drejtë me strukturën anatomike të pulës (qafë, krahë, kofshë dhe gjoks).

Çdo parti, mishi shoqërohet me çertifikatë veterinare.

Mishi i pulës të jetë i kontrolluar nga veterineri dhe i shoqëruar me Raport Veterinar, të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

## **3.SALLAM**

### **Treguesit Organo-Leptikë:**

Me perberje mish lope, vici ose derri, i fresket dhe i pajisur me certifikate nga AKU-ja, të mos përmbajë shumë yndyrë dhe të transportohet me mjete frigoriferike. Mishi të jetë ngjyrë rozë dhe të ketë erë të këndshme. Malli të jetë i shoqëruar me çertifikatë cilësie.

# ORIGJINË JO SHTAZORE

## IV.

### 1.BUKË GRURI

*BUKË ME MIELL GRURI - Bazuar ne STASH 1411/87*

**Lloji:** Bukë gruri me miell rreze 75 %

**Treguesit Organo-Leptikë:**

**Korja:** E lëmuar, pa pjesë të djegura, pa çarje dhe shkëputje të kores nga tuli. Ngjyra e njëllajtë e kuqerremtë në kafe të çelët.

**Tuli:** Masa e njëllajtë e pjekur mirë, me pore të shpërndara mirë, në mënyrë të njëllajtë. Pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, jo i thërrmueshëm, pa shtresa.

**Era dhe shija:** E këndshme, karakteristike e bukës së pjekur mirë. Pa erë myku, thartirë dhe hidhërimi dhe erë e shije tjetër të huaj.

**Forma:** E rregullt, pa shtypje dhe deformime.

**Lëndët e huaja:** Nuk lejohen.

**Treguesitkimik:**Nëpërputhje me StandartinShtetërorShqiptar.

**Lagështiranë %** jo më shumë se 45

**Poroziteti në %** jo më pak se 70

**Aciditeti në gradë** jo më shumë se 4.5

**Ambalazhimi:** Çdo bukë të futet në qese letre me masën 1000 gr ose 500 gr, këto të futura në kuti kartoni.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

**Transporti i bukës:** Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### 2. VAJ ULLIRI I VIRGJËR

*STASH 102-87*

*Ligji nr. Nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit” Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshëmrisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”*

#### **Vaj Ulliri i Virgjër**

Vaji i ullirit i virgjër është vaji i ulliri i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 2 gramë për 100 gramë dhe ka karakteristika si më poshtë:

**Treguesit organo leptikë:**

- Pamja e jashtme te jete e kthjellet dhe pa asnjë turbullire.
- Ngjyra te jete e verdhe deri ne lehtësisht jeshile.
- Era dhe shija karakteristike te vajit te ullirit. Nuk duhet te përmbaje lende te huaja. Nuk duhet të jete i rafinuar.
- Ambalazhimi në shishe qelqi 0,5 - 1 litër.
- Nuk duhet të jetë i përzier me vajra te tjera dhe konservante.

**Treguesit e tjerë fiziko kimik (analiza fiziko-kimike):**

- Lagështia dhe lëndë flurore në % m/m  $\leq 0.2\%$
- Aciditeti i lirë në %  $\leq 2\%$
- Numri i peroksideve  $\leq 20$  mek O<sub>2</sub>/kg
- Koeficienti i perthithjes ultraviolet (UV)- (K 1% 1cm)  
\*K(232)  $\leq 2.60$

$$*K(270) \leq 0.25$$

$$*\text{Delta } K \leq 0.01$$

-Numri i Jodit (Sipas Eëijs) 75-94

### **Etiketimi:**

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.

Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Raport analizat e kërkuara:**

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

## **V.**

### **FRUTA**

*Frutat te jene sipas stines duke perfshire te gjitha llojet si: portokalle, molle,dardhe,rrush,banane etj. Ambalazhimi me qese, pesha sipas kerkesave te Entit.*

#### **1.MOLLË**

*Bazuar në STASH 1752/88*

**Lloji:**Mollë për treg cilësia e parë

**Treguesit Organo-Leptikë:**

**Pamja e jashtme:** të freskëta,me zhvillim normal,të shëndosha e me bisht.Me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime

**Pjekuria:**me 3 pjekuri teknike të njëjtë.

**Era dhe shija:**Pa erë dhe shije të huaj.

**Madhësia e kokrrës** (prerëgjjerazi ,nëdiametrinmëtëmadh)

Kultivarët me kokërrtëzgjatur jo mëpak se 70 mm

Kultivarët me kokërrtërrumbullakëtjo mëpak se 80 mm

Kultivarët me kokërrtëvogël jo mëpak se 60 mm

Dëmtimemekanikenuklejohen.Tëprekurangasëmundjetdheinsektetnuklejohen.Tëkalbura, tëngrira,njollanga

Monilia (kalbëzim) lëndëtëhuajanuklejohen.

Nga krimbi (pa galeri në brendësi) nuk lejohen.

Nga fuzikladi (kroma e pikalorja) nuk lejohen.

Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë .Nuk lejohen

Gunga (kallo) njolla në lëkurë.Nuk lejohen.

Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen.Përmbajtja e pesticideve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

**Ambalazhimi dhe etiketimi:** Frutat ambalazhohen sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standartave dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti.Frutat mund të ambalazhohen dhe në qeska plastmasi , rrjeta ushqimore duke ruajtur freskinë dhe konsistencën e frutave.



## 2.PORTOKALLE

*Bazuar në STASH 1722/88.*

**Lloji:** Portokalle për treg cilësia e parë.

**Treguesit Organo-Leptikë:**

**Pamja e jashtme:** të freskët, me zhvillim normal, të shendoshë dhe me bisht.

Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 % .Me pjekuri teknike të plotë.

**Ngjyra, shija dhe aroma:** Ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të atet, pa shije të hidhur.

**Madhesia e kokrres** (diametri me i madh) në mm jo me pak se 70.

Demttime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.

Lende të huaja nuk lejohen.

Gervishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.

Të prekura nga oleooza lejohen 2 – 3 njolla për kokërr.

Permbajtja e pesëditëve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. **Ambalazhimi dhe etiketimi:** Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra. Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

## 3.BANANE

**Lloji:** Kërkohej çilesi e parë

**Treguesit Organo-Leptikë**

**Pamja e jashtme:** të freskëta, me zhvillim normal, në tufë, me pjekuri teknike të plote

**Ngjyra, shija dhe aroma :** Ngjyra të jete jeshile në të verdhë, me erë dhe aromë të këndshme .karakteristike e

ketij kultivari.

Madhesia e kokrres të jete mesatare.

Demttime mekanike nuk lejohen.

Njolla të kafeta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.

Gervishtje të lekures nuk lejohen.

Zbutje të lekures nuk lejohen.

**Ambalazhimi** të jete në kuti kartoni standarte tipike për tregimin e bananës .

Malli të jete i shoqëruar me etiketën e çilesisë .

## VI ZARZAVATE

*Zarzavate të jenë sipas stinës duke përfshirë të gjitha llojet si: Domate, qepe, specë, patllixhana, karrota, presh, laker, etj. Ambalazhimi me qese, pesha sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

*Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoreve të tjera atmosferikë duke zbatuar rregullat higjienë – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.*

## 1.PATATE

*Bazuar në STASH 1729/88*

**Patate verore e dimërore, cilësia e parë.**

**Treguesit Organo-Leptikë të patates verore e dimërore:**

**Pamja e jashtme:** Të plota, të forta, të pastra në sipërfaqe e të thata , jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

**Pjekuria:** Kokrra të pjekura.

**Madhësia e kokrrës (diametri më i madh) mbi:**

për të rumbullaktat dimërore 5 cm; verore 4 cm.

për vezaket dimërore dhe verore 4 cm.

për të zgjaturat 3.5 cm.

**Lejohen:**

a. lehtësisht të gjelbra jo me shume se 3 % për dimëroret; 1 % për veroret;

b. të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen për veroret;

c. lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret;

d. të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;

e. të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;

f. zgjebe me plagë deri në 1/5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 %.

g. njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1/5 e siperfaqës së kokrrës nuk lejohen;

h. dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .

i. Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

**Ambalazhimi dhe etiketimi:** Patatet ambalazhohen të ndara sipas kultivareve në arka. Patatet mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë.

## 2.KARROTA

**Karrota, cilesia e pare.**

**Treguesit Organo-Leptikë:**

**Pamja e jashtme:** Të freskët me ngjyrë portokalli në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta.

**Përbërja e brendshme e tulit:** Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm.

**Madhësitë:** Gjerësia (diametri me i madh) deri në 4 cm,gjatësia 10 -15 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkure ) në % jo më shumë se 2.

Të prekura nga sëmundjet, insektet e të kalbura: Nuk lejohen.

**Ambalazhimi dhe etiketimi:**Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta,të thata.

## 3.QEPE E THATE

**Treguesit Organo-Leptikë:**

**Pamja e jashtme:** Me pjekuri të plotë.Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota.Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit.

**Diametri** (madhësia e kokrrës): për ovalet 4-8 cm. për llojet e tjera 5-10 cm.

**Dëmtime mekanike:** Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta).

**Me sëmundje:** Nuk lejohen.

Të ngrira, të kalbura e të mykura: Nuk lejohen.

**Ambalazhimi dhe etiketimi:** Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta, të thata e të prodhuara sipas standartit ose kushteve teknike në fuqi.

Qepa e thatë mund të ambalazhohet edhe në rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në grykë.

**Diametri:** Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara), madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor). Për të hershmet 5 cm, për të mesmet dhe të vonat 7 cm. Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm).

